



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHITES



MUNICIPALITY OF SHITIME/ OPSTINA STIMLJE

Zyra e Kryetarit të Komunës

/Kancelarija presednika opstine/mayor's office

Zyra për Informim/ Information Office/ Kancelarija za Informisanje

Procesverbal nga mbledhja e V- të e KKSBB-së e mbajtur më 5 nëntor (e mërkurë) 2025, në ora 10:00, në Sallën e vogël të Ndërtesës së Komunës.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Faruk Beqa (Nënryetari i Komunës së Shtimes), Haxhi Behluli (Komandant i policisë), Altin Avdiu (FSK), Albert Ramadani (KLSP), Skënder Dauti (K.Sh), Reshat Gashi (ZBGJ-ZKO), Ilir Fejzullahu (Inspektor i tregut), Bajram Gashi (NJPZSH), Vlora Hyseni (Z.I), Admire Selmani (Z.I), Teuta Mustafa (Z.I) .

Nënkryetari Faruk Beqa: Pra, sot është mbledhja e pestë e KKSBB-së, rendi i ditës është:

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 29.9.2025,
2. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës,
3. Siguria ushqimore (kontrolli i cilësisë, kushteve dhe shpërndarjes së produkteve ushqimore,
4. Identifikimi i hershëm dhe ndërhyrja e hershme për parandalimin e radikalizmit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm,
5. Të ndryshme.

D.m.th e kemi këtu siç po e shihni në agjendë edhe pikën e 4-t "Identifikimi i hershëm dhe ndërhyrja e hershme për parandalimin e radikalizmit" për faktin pra që e kemi një pyetësor të cilin na e kanë dërgu, i ka pesë faqe dhe ne kemi punuar në të; janë një numër i madh i pyetjeve që shtrohen pikërisht për këtë.

Të gjithë anëtarët e pranishëm u pajtuan dhe votuan unanimitisht për procesverbalin dhe për pikat e rendit të ditës.

Për pikën e dytë fjalën e merr Haxhi Behluli, Komandant i Policisë në komunën e Shtimes dhe na dha info për gjendjen e muajit tetor të këtij viti.

Haxhi Behluli: Faleminderit prej të gjithëve. Unë në pika të shkurtra po mundohem me shpjegu, edhe në bazë të statistikave çështjen e sigurisë dhe realisht nëse kemi edhe dukuri të tjera që rajoni ynë përballlet me to, ose duhet marrë iniciativa për të rregulluar çështjen e sigurisë. Megjithatë, në takimin e kaluar kemi dhënë statistika për 9 mujorin e këtij viti, e në këtë takim besoj mjafton të jap statistika për muajin tetor, d.m.th statistika në pika të shkurtra t'i referohemi çka kemi pasë prej veprave penale edhe çështjeve të tjera që janë trajtu nga policia, në bashkëpunim edhe me komunën, edhe me akterët tjerë që i kemi dhe me përkrahësit e sigurisë. Në bazë të raportit që e kemi ne prej statistikave të përgjithshme, na tregojnë që e kemi një situatë stabile, duke u bazuar në disa raste që ne i vlersojmë prej aspektit të sigurisë, siç i kemi p.sh. lëndimet e rënda, vrasjet, grabitjet ose incidenteve madhore, d.m.th. tek ne fatmirësisht është një situatë e qetë, nuk i kemi këto situata, realisht kemi kaluar një muaj të mirë, duke mos përjashtuar edhe veprat e tjera, pra me raste jemi në ngritje, i kemi 39 raste në krahasim me vitin e kaluar që ishin 20 raste. Këto raste përfshijnë kanosje, lëndim të lehtë, ngacmim, rrezikim në vendin e punës, vjedhje, vjedhje e rëndë, domethënë të gjitha këto vepra që janë në kodin penal janë trajtuar tek ne dhe janë në procedim, faktikisht janë duke u trajtuar edhe nga njësia e hetimeve. Vlen të ceket rasti më shqetësues që ka qene "rrezikim në vendin e punës" ku një person është lënduar në vendin e punës dhe fatkeqësisht pas dy javësh në QKUK ka ndërruar jetë. Pastaj e kemi edhe një rast vdekje e dyshimtë tek Enti Special, që ka pasur hetim mbi vdekjen nga ana e policisë, por që realisht personi ka ndërruar jetë si pasojë e probleme shëndetësore. Përndryshe, prej rasteve grabitje, tentimvrasje, këto nuk i kemi pasë, falë qytetarëve dhe institucioneve si Policia, Organet Komunale, FSK-JA, KFOR-i që jemi në lëvizje dhe faktikisht kjo e ka sjellë një situatë të qetë që nuk kemi raste të tilla. Në pika të shkurtra unë po e cek te kanosjet që kemi pasur 0 raste në vitin e kaluar, ndërsa këtë vit i kemi 5. Kanosjet tek ne më shumë janë duke u bërë nga rrjetet sociale, ndoshta nuk janë prej moshave të reja por janë edhe prej situatave që dikush sfidohet prej rrjeteve sociale, por nuk janë kanosje që kanë ndikuar edhe shumë tek palët. Lëndime të rënda nuk kemi pasë. Te vjedhjet i kemi 3 vjedhje të zakonshme, te vjedhjet e rënda jemi 1 me 1, d.m.th. siç ka qenë në vitin e kaluar edhe tash e kemi vetëm një rast. Është për tu lavdëruar ne si komunë e Shtimes, dhe të gjitha institucionet përkatëse që jemi për çështjen e sigurisë, që në krahasimet me stacionet e tjera policore Rajonale, ne kemi raste të vjedhjeve më pak se të tjerët. Te dhuna në familje i kemi pas 2 raste vitin e kaluar, ndërsa tash e kemi 1 rast; te hyrjet në sistemet kompjuterike e kemi 1 rast, për armëmbajtje pa leje e kemi pasur 1, uzurpim prone e kemi 1 rast, pengim i procesit të votimit është hapur 1 rast dhe është duke u trajtuar, vjedhje e pyjeve është 1 rast. Sa i përket sigurisë në komunikacion rrugor, prej këtyre 39 rasteve, 14 janë aksidente trafiku me dëme materiale të vogla, në krahasim me vitin e kaluar që ishin 6. Sa i përket rritjes së përgjegjësisë në trafik ka vetëdijësim të vozitësve pasi ka përgjysmim të gjobave krahasuar me vitin e kaluar, pra këtë muaj janë shqiptuar 314 tiketa. Në përgjithësi do ta kisha përmendur fokusin që ne

duhet të kemi rreth sigurisë në komunikacion dhe sigurisë në shkolla. Është më rëndësi që e kemi një rini të shëndoshë, por që nganjëherë janë të rrezikuar nga situatat e ndryshme, ne fokusohemi te parandalimi i drogave dhe i mbajtjes së mjeteve të ftohta. Pastaj me komunën e kemi një bashkëpunim të mirë te vendosja e kamerave, ne e kemi bërë edhe një vlerësim të situatës me IT-në e Policisë në rajonin tonë që KFOR-i turk ka shprehur vullnetin për vendosjen e kamerave nëpër fshatra. Ne e kemi bërë një hartografi se ku do të vendosen këto kamera, pra jemi në bisedime nëse mund të arrijmë të marrim këtë donacion nga ta. Ndërsa çështja teknike e vendosjes së tyre mbetet të bashkëpunohet me komunën, përkatësisht me Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Nëse ka dikush ndonjë pyetje ne mund të përgjigjemi.

Faruk Beqa: Faleminderit komandant.

Ilir Fejzullahu: E kam një pyetje për kërcënimet që ndodhin në rrjetet sociale sidomos në Tiktok. A bëhen procese për to apo mbeten ashtu siç janë pa u trajtuar?

Haxhi Behluli: Neve gjithëherë na duhet një ankues në mënyrë që të ndërmerren masa, në rastet kur kemi fakte. Fatmirësisht tashmë ne e kemi një njësi që është trajnuar dhe është duke vepruar në nivel rajonal. Më herët nuk e kemi pasur, ndërsa në vitin 2025 është instaluar në njësinë e krimeve të rënda dhe ata bashkëpunojnë me hetuesit tanë. Ka raste që ne kemi dërguar persona në mbajtje për 48 orë e pastaj iu është vazhduar edhe për 30 ditë prej gjykatës, që është zbulu prej rrjeteve sociale që ka qenë i kanosur, i ngacmuar apo i degraduar domethënë që ka rezultat kjo procedurë.

Faruk Beqa: Atëherë kalojmë te pika e 3-të e rendit të ditës për sigurinë ushqimore.

Ilir Fejzullahu: Të nderuar pjesëmarrës dhe përfaqësues të institucioneve. Unë si inspektor i tregut mundohem të sigurohem që produktet që shiten (konsumohen) nëpër bizneset tona, mundohem që të jenë sipas standardeve ligjore dhe sa më të sakta për konsumatorët. Sigurisht që kujdesi për produktet duhet të jetë ligjor dhe të mos paraqesë ndonjë rrezik për shëndetin apo jetën e njerëzve. Detyra jonë kryesore është që të jemi vigjilent dhe sa më profesional e korrekt në kërkesën e detyrave tona, si në regjistrimet e bizneseve, pëlqimet për aktivitet biznesi, gjithashtu për mallrat që kanë etiketë ose deklaracion që kohët e fundit kemi pasur goxha probleme në komunën tonë, por zakonisht ndodh për arsye të bartjes nga një biznes në një biznes tjetër, ka mundësi që të iu humbasin deklaracionet. Vetëm gjatë vitit 2024 i kam hartuar rreth 70 procesverbale, me 12 aktvendime dhe 8 gjoba. Propozim përmbarimi i kemi pasur 2 dhe shuma e gjobave ka qenë rreth 6 mijë euro. Ndërsa në gjashtë-mujorin e parë të vitit 2025 kemi pasur rreth 20 procesverbale, 4 me aktvendime dhe 4 me gjoba. Propozim përmbarimi i kemi aktualisht 2 dhe në përgjithësi vërejmë një vetëdijësim më të lartë nga bizneset që operojnë në komunën tonë, duke pasur parasysh se inspektimet dhe njësitë për siguri janë shumë më shpesh në inspektime të bizneseve. Tash jemi ndarë në Inspektoratin e Punës dhe Inspektoratin e Tregut dhe Shërbimeve Publike, e më herët kemi qenë në një drejtori. Kjo ka bërë që inspektimet më të shpeshta të ngrisin ndërgjegjësimin e bizneseve në komunën tonë. Këto masa dhe inspektime kanë bërë që përveç

bizneseve edhe qytetarët të vetëdijësohen pasi ankohen si në inspektorat në Komunën e Shtimes, si në inspektorat në Ferizaj. Problemet në të mëdha në të kaluarën kanë qenë deklaracionet dhe etiketat dhe regjistrimi i biznesit, po tashmë ka një vetëdijësim si për regjistrim të biznesit, në licenca të punës edhe në pëlqimet për aktivitet të biznesit dhe në higjieno-teknikë; më herët kanë qenë më të rralla ndërsa tash i bëjnë vet më shpesh pasi e dinë që ne vazhdimisht dalim në inspektim, dhe për shkak që mos të vjen deri tek ndonjë ndëshkim me gjoba ose me ndonjë procesverbal, ata i kryejnë edhe vet. Nëse ka ndonjë pyetje, urdhëroni.

Faruk Beqa: A ka pasur verës ndonjë helmim apo parregullsi?

Ilir Fejzullahu: Jo, fatmirësisht vera ka shkuar shumë mirë, nuk kemi pasur ndonjë rast të jashtëzakonshëm. Të gjitha punët në lëminë e tregut kanë shkuar mirë.

Faruk Beqa: Më vjen mirë që kjo tash po trajtohet në mënyrë më serioze.

Albert Ramadani: Përshëndetje për të gjithë, dy pyetje i kam për Ilirin meqenëse është në inspektorat; sa inspektorë i ka komuna e Shtimes pa regjion, dhe pyetja e dytë a ka inspektim për shitësit ambulantë për produktet e qumështit e të djathit që shiten në ambient të hapur kur është moti i nxehtë, dhe sa është numri i shitësve ambulantë statik.

Ilir Fejzullahu: Faleminderit për pyetjen Albert. Ne aktualisht në komunën e Shtimes i kemi katër inspektorë; një të ndërtimit, një të tregut, një i shërbimeve publike dhe një i mjedisit. Sa i përket shitësve ambulantivë të qumështit përgjegjës jam unë që i monitoroj për faturat e shitjes dhe të blerjes, ndërsa për cilësinë përgjegjës është inspektorati sanitar pasi ata i kanë pajisjet e posaçme për kontrollimin e cilësisë.

Haxhi Behluli: A bëhen inspektime edhe te kioskat dhe kafiteritë që shesin produkte që duhet të shiten për një moshë të caktuar e jo për fëmijët apo nxënësit e shkollës?

Ilir Fejzullahu: Kemi raste të tilla, p.sh. kemi pasur lajmërim për shitje të cigareve me copa për të cilin kemi marrë masa, por edhe në kafiteritë e qytetit gjithsesi.

Faruk Beqa: Dua të ju njoftoj që tashmë jemi në fazën e fundit të ndërtimit të tregut e kjo do të ndikojë edhe në përmirësimin e kushteve higjienike edhe për shitësit e bylmetit. Nëse s'ka pyetje të tjera do të kisha vazhduar me pikën e katërt që është rreth parandalimit të radikalizmit. E përmenda edhe në fillim që ne e kemi pranuar një pyetësor me pesë faqe dhe një numër të madh pyetjesh. Ne e dimë që në nivelin nacional është një strategji që merret me parandalimin e shfaqjes së radikalizmit të të gjitha formave por edhe të atij fetar. Fatmirësisht si komunë qëndrojmë mirë dhe nuk është paraqitur ndonjë rast apo ndonjë pikë që paraqet rrezik nga ekstremizmi. Kësisoj unë e kisha përmbyll këtë pikë me mesazhin që të jemi vigjilentë sa i përket sigurisë lokale. Atëherë kalojmë të pika e pestë; të ndryshme, nëse dikush ka ndonjë koment?

Albert Ramadani: Megjithëse mungon Kryetari i Bashkësisë Islame në Shtime, ai e ka një ndikim të madh tek komuniteti, në raport me pikën e parafundit. Ai e ka një peshë që mund të shtrihet më gjerë përmes ligjëratave nëpër xhamitë e komunës.

Faruk Beqa: Atëherë ju falënderoj për kontributin e dhënë, konsideroj që takimi ka arritur qëllimet e veta dhe vazhdojmë të bashkëpunojmë në të mirë të qytetarëve për të shtuar sigurinë në komunitet. Mirupafshim në takimet tjera të radhës.

Mbledhja ka përfunduar në ora 10:55

Procesmbajtës:

Vlora Hyseni



Lista e pjesëmarrësve në mbledhjen e V-të, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Shtime, 5 nëntor 2025

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1	Skënder Dauti	Komuna Shtime	Dauti
2	ALTIN ARDIU	FSK	Ardu
3	Albert Ramodeni	KLSP	Ramodeni
4	FARUK BEGA	NEWKRYETAK	Bega
5	Reshat Gashi	ZBGT - ZKO	Gashi
6	Ilir Ferizullahu	KOMUNA SHITIME INSPEKTOR I TRIGUT	Feriz
7	Bojram Gushi	PSH / NDRIT SHITIME	Gushi
8	HAXHI BEHULLU	POUCIA KOMANDANT	Behullu
9	Admire Selmani	Z. Informimit K. SHITIME	Selmani
10	Tenta Mustafa	Z. Informimit K. Shtime	T. Mustafa
11	Vlora Hyseni	Z. Informimit	Hyseni
12			
13			
14			
15			
16			
17			